

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: INSTALIMI I SISTEMIT ELEKTRONIK E-GATE PËR PKK PORTI DURRËS DHE PKK PORTI SARANDË

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 42961100-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 137,388,000 (Njëqind e tridhjetë e shtatë milion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë) Lekë, pa TVSH, ose 1,425,186.72 (Një milion e katërqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e dy)

(Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (96.40), datë(17.02.2026)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektivit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me certifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;
S SH ISO/IEC 27001 mbi – “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, “Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;
S SH ISO/IEC 20000-1 “Menaxhimi i shërbimit TI”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme Ky standard lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e objektit. Ky standard garanton që operatori ekonomik disponon një sistem të certifikuar për menaxhimin e proceseve, kontrollin e cilësisë së shërbimeve dhe monitorimin sistematik të performancës. Në projekte që përfshijnë infrastrukturë kritike dhe ndërveprim me sisteme shtetërore, mungesa e një sistemi të strukturuar të menaxhimit të cilësisë rrit ndjeshëm riskun e gabimeve teknike, vonesave, moskoordinimit ndërmjet ekipeve dhe defekteve funksionale.

S SH ISO/IEC 27001 mbi – “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, “ Siguria e informacionit, siguria kibernetike dhe mbrojtja e privatësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme; Ky standard lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e sistemit elektronik E-Gate, i cili operon në mjedis me ndjeshmëri të lartë sigurie dhe përfshin përpunimin dhe transmetimin e të dhënave sensitive, përfshirë të dhëna biometrike dhe ndërveprim me sisteme shtetërore ekzistuese. Implementimi dhe funksionimi i një sistemi të tillë kërkon menaxhim të strukturuar të rreziqeve të sigurisë së informacionit, kontroll të aksesit, mbrojtje të rrjeteve dhe trajtim të incidenteve kibernetike, në mënyrë që të garantohet konfidencialiteti, integriteti dhe disponueshmëria e të dhënave. Gjithashtu, ky standard dëshmon se operatori ekonomik disponon procese të formalizuara dhe të auditueshme për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit, duke reduktuar riskun operacional dhe ligjor për Autoritetin Kontraktor dhe duke garantuar zbatim të sigurt dhe të kontrolluar të sistemit E-Gate.

S SH ISO/IEC 20000-1 “Menaxhimi i shërbimit TI”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme. Sistemi E-Gate, përveç fazës së instalimit dhe integritit, kërkon menaxhim të vazhdueshëm operacional, mbështetje teknike dhe garantim të niveleve të shërbimit gjatë periudhës së funksionimit. Operimi në mjedise kufitare me kërkesa të larta sigurie dhe disponueshmërie kërkon procese të strukturuar për trajtimin e incidenteve, menaxhimin e ndryshimeve, kontrollin e konfigurimeve dhe monitorimin e performancës së sistemit. Ky standard dëshmon se operatori ekonomik aplikon praktika të standardizuara dhe të auditueshme për organizimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve TI, duke garantuar funksionim të qëndrueshëm dhe të kontrolluar të sistemit gjatë gjithë ciklit të jetës së kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga një distributor i autorizuar nga prodhuesi, për të gjithë komponentët hardware, software dhe licencat përkatëse të përfshira në objektin e kësaj procedure prokurimi, sipas specifikimeve teknike. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenit 40, pika 3 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi ose distributor i autorizuar për të gjithë komponentët hardware, software dhe licencat përkatëse justifikohet nga kompleksiteti dhe rëndësia kritike e sistemit E-Gate, i cili përfshin pajisje biometrike, sisteme kontrolli aksesi dhe platforma software që ndërveprojnë.

Autorizimi garanton që produktet janë origjinale, të licencuara dhe të mbështetura zyrtarisht nga prodhuesi, si dhe që operatori ekonomik ka të drejtën ligjore për instalim, konfigurim, përditësim dhe mirëmbajtje. Kjo redukton rrezikun e furnizimit me pajisje jo autentike, licenca të parregullta apo produkte pa mbështetje teknike, duke siguruar përputhshmëri me specifikimet teknike dhe funksionim të qëndrueshëm të sistemit.

Përfshirja e të dhënave të plota të prodhuesit në autorizim është e nevojshme për t'i mundësuar Autoritetit Kontraktor verifikimin e vlefshmërisë dhe autenticitetit të dokumentit, duke garantuar transparencë dhe siguri juridike gjatë zbatimit të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë stafin e nevojshëm për realizimin e projektimit teknik, instalimit, konfigurimit, integritit, testimit dhe mirëmbajtjes së sistemit Automatic Border Controller (E-Gate), minimalisht si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) Menaxher Projekti i certifikuar (PMP ose ekuivalent), për menaxhimin e projekteve TIK
 - b) Të paktën 3 inxhinierë IT
 - c) Të paktën 1 (një) specialist për projektim arkitekture serverash, storage dhe mjedise on-premise me disponueshmëri të lartë (high availability).
 - d) Të paktën 1 (një) inxhinier rrjeti i certifikuar (CCNA/CCNP ose ekuivalent), për segmentim rrjeti, firewall dhe komunikim të sigurt ndërmjet sistemeve.
 - e) Të paktën 1 (një) administrator sistemi i certifikuar për Windows Server/Linux ose ekuivalent, për konfigurimin e mjediseve virtuale (VMware, Hyper-V ose ekuivalent).
 - f) Të paktën 1 (një) specialist me certifikim në fushën e sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001 Lead Implementer, ISO/IEC 27001 Lead Auditor, CISM, CISSP ose ekuivalent), në përputhje me kërkesat e sigurisë së sistemit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (GDPR).
 - g) Të paktën 1 (një) specialist për zhvillimin ose përshtatjen e komponentëve software server-side të sistemit.
 - h) Të paktën 1 (një) specialist për implementimin dhe konfigurimin e integritit të sistemit përmes API-ve të sigurta, web services ose mekanizmave të ndërveprimit institucional.
- i) Systems Integration Specialist (Secure APIs & Web Services)
 - j) Certified Web Services & API Integration Engineer
 - k) Secure Systems Integration Professional (Institutional Interfaces)
 - l) Institutional Integration Specialist — APIs & Web Services
 - m) API & Institutional Interoperability Certification (Professional level ose ekuivalent).

- n) Të paktën 2 (dy) specialistë për mirëmbajtjen e sistemit dhe menaxhimin e incidenteve gjatë periudhës së kontratës, në përputhje me kërkesat për SLA.

Për punonjësit e mësipër duhet të paraqitet:

- Diplomë universitare në Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Shkenca Kompjuterike ose fusha të ngjashme; kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.
- Certifikatat ose Transkriptet përkatëse (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar) të lëshuara nga organe certifikuese.

Shënim: Punonjësit e kërkuar në këtë kriter në mënyrë të kombinuar mund të përmbushin një apo disa fusha/kualifikime të kërkuara.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Qëllimi i këtij kriteri është të garantojë që operatori ekonomik disponon personel të kualifikuar dhe të certifikuar, i cili është thelbësor për realizimin e kontratës me sukses, duke pasur parasysh specifikat teknike dhe natyrën e shërbimit. Ky kriter është bazuar në analizën e specifikimeve teknike dhe termave të referencës të hartuara nga Autoriteti Kontraktor.

Menaxher Projekti i certifikuar (PMP ose ekuivalent). Kërkesa për Menaxher Projekti të certifikuar (PMP ose ekuivalent) është e justifikuar nga natyra komplekse dhe shumëfazore e projektit. Realizimi i suksesshëm i projektit kërkon planifikim të strukturuar, koordinim ndërmjet palëve të përfshira, menaxhim të riskut, kontroll të afateve dhe raportim periodik. Prania e një menaxheri projekti të certifikuar garanton zbatim të metodologjive të njohura ndërkombëtarisht për menaxhimin e projekteve TIK.

Inxhinierë IT. Kërkesa për inxhinierët IT buron nga kompleksiteti teknik i projektit dhe nga nevoja për të garantuar instalimin, konfigurimin dhe integrimin e infrastrukturës server, rrjetit dhe mekanizmave të sigurisë në mënyrë të koordinuar dhe të sigurt. Duke qenë se sistemi do të operojë në tre lokacione të ndryshme (Porti i Durrësit, Porti i Sarandës dhe mjediset e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit), kërkohet mbulim teknik paralel në terren, koordinim ndërmjet pikave operative dhe garantim i funksionimit të qëndrueshëm dhe të integruar të sistemit. Angazhimi i inxhinierëve siguron ndarje të qartë përgjegjësisë, reduktim të riskut operacional dhe përmbushje të standardeve të sigurisë dhe performancës në të gjitha vendndodhjet.

Specialisti për projektim arkitekture serverash, storage dhe mjedise on-premise me disponueshmëri të lartë (high availability), projektton dhe implementon arkitekturën e

infrastrukturës serverike me disponueshmëri të lartë (HA), duke garantuar balancim ngarkese, backup dhe rikuperim nga fatkeqësitë. Gjithashtu, siguron që sistemi E-Gate të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme dhe pa ndërprerje në mjedise kritike. Projektimi i saktë i arkitekturës së serverëve dhe sistemeve të storage është thelbësor për të garantuar performancë, shkallëzim, siguri të të dhënave dhe rikuperim në rast dështimi.

Inxhinieri i rrjetit i certifikuar (CCNA/CCNP ose ekuivalent), për segmentim rrjeti, firewall dhe komunikim të sigurt ndërmjet sistemeve, është përgjegjës për projektimin dhe konfigurimin e segmentimit të rrjetit, firewall-eve, VPN-ve dhe komunikimit të sigurt ndërmjet komponentëve të sistemit dhe databazave shtetërore. Garantohen lidhje të enkriptuara, kontroll i aksesit dhe mbrojtje ndaj kërcënimeve të jashtme.

Administratori i sistemit i certifikuar për Windows Server/Linux ose ekuivalent, për konfigurimin e mjediseve virtuale (VMware, Hyper-V ose ekuivalent), administron mjediset serverike dhe virtuale (Vmware, Hyper-V ose ekuivalent), realizon konfigurimin e sistemeve operative, menaxhimin e përdoruesve, politikave të sigurisë dhe monitorimin e performancës. Siguron funksionim të qëndrueshëm të platformës aplikative dhe bazave të të dhënave. Është i domosdoshëm për garantimin e funksionimit të qëndrueshëm, përditësimin të kontrolluar dhe mbrojtjes së sistemit nga ndërhyrje të paautorizuara.

Specialisti me certifikim në fushën e sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001 Lead Implementer, ISO/IEC 27001 Lead Auditor, CISM, CISSP ose ekuivalent), në përputhje me kërkesat e sigurisë së sistemit dhe mbrojtjes së të dhënave personale (GDPR), vlerëson dhe menaxhon riskun e sigurisë së informacionit, harton dhe implementon politika sigurie, kontrollon konfigurimet e sigurta dhe monitoron përputhshmërinë me standardet e sigurisë dhe kërkesat për mbrojtjen e të dhënave (përfshirë të dhënat biometrike dhe GDPR). Siguron integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e sistemit.

Specialisti për zhvillimin ose përshtatjen e komponentëve software server-side të sistemit, zhvillon dhe përshtat komponentët aplikativë server-side të sistemit, realizon konfigurimin e shërbimeve, logjikën e ndërveprimit me databaza dhe optimizimin e performancës. Siguron që sistemi të përmbushë kërkesat funksionale dhe teknike të përcaktuara në specifikime. Ky rol është i nevojshëm nga nevoja për adaptim të sistemit në përputhje me kërkesat operacionale dhe integrimin me sisteme ekzistuese.

Specialist për implementimin dhe konfigurimin e integritetit të sistemit përmes API-ve të sigurta, web services ose mekanizmave të ndërveprimit institucional, është përgjegjës për implementimin e integritetit ndër-institucional përmes API-ve të sigurta, web services dhe mekanizmave të ndërveprimit institucional. Garantohen autentikim i sigurt, enkriptim i komunikimit dhe shkëmbim i besueshëm i të dhënave me sistemet ekzistuese shtetërore.

Specialisti për mirëmbajtjen e sistemit dhe menaxhimin e incidenteve gjatë periudhës së kontratës, në përputhje me kërkesat për SLA, ky specialist menaxhon monitorimin operacional të sistemit gjatë periudhës së kontratës, trajton incidentet sipas niveleve të SLA-së, realizon ndërhyrje korrigjuese dhe parandaluese dhe siguron vazhdimësinë e shërbimit pa ndërprerje në mjedis kritik.

Numri i punonjësve dhe profilet profesionale, të kombinuara, janë përcaktuar bazuar në natyrën e shërbimit, duke u përputhur me specifikimet teknike, termat e referencës, objektin e prokurimit dhe proceset e punës që ky shërbim duhet të mbulojë. Këto profile sigurojnë realizimin e plotë, të sigurt dhe të integruar të sistemit, duke garantuar funksionim të qëndrueshëm, mbrojtje të të dhënave dhe minimizim të riskut operacionel gjatë implementimit dhe periudhës së operimit.

2.3.5 Operatori ekonomik deklaron se sistemi i propozuar do të implementohet dhe operojë në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë së informacionit dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kjo deklaratë shërben si garanci nga operatori ekonomik se zgjidhja e propozuar do të projektohet, implementohet dhe të operojë në përputhje me standardet e sigurisë së informacionit. Kjo deklaratë redukton riskun operacional, pasi krijon një bazë të qartë përgjegjësie në rast mosrespektimi të kërkesave të sigurisë së të dhënave. Shërben për të siguruar që sistemi do të mbështetet mbi praktika të strukturuar sigurie dhe kontrolli.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi i punës i caktuara nga titullari i autoritetit kontraktor “Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit”, bazuar në nevojat e të cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë pjesë e pandarë e DST

Argumentimi i kriterëve të pikëzuar dhe mënyra e llogaritjes së pikëve:

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (në vijim “LPP”), konkretisht pika 1 e nenit 87 të LPP, ku parashikohet se: “*Autoritet/entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme*”, të cilat lënë në diskrecionin e AK përcaktimin e mënyrës së vlerësimit, si dhe duke vlerësuar natyrën e objektit të prokurimit, dhe proceset që përfshin ky shërbim, AK vlerëson më të përshtatshme dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht të favorshme, për arsyet si më poshtë (në mënyrë të përmbledhur):

Kjo metodë vlerësimi nxit konkurrencë cilësore, shmang praktikën e ofertave jo reale, pasi siguron AK se ofertuesit sigurojnë besueshmërinë e organizimit të shërbimit duke dhënë një zgjidhje teknike sa më efektive, sigurojnë nivelin e ekspertizës dhe paraqesin kosto reale të justifikuar për kryerjen e shërbimit sipas specifikimeve teknike.

Kriteri:

1. Çmimi:

65 pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

2. Kualifikimi dhe kompetencat profesionale të stafit teknik.

0 - 35 pikë

Argumentimi: Vlerësimi në pikë për kualifikimin profesional dhe përvojën e stafit teknik është vendosur për të siguruar një diferencim real të cilësisë në një projekt që përfshin instalimin, integrimin dhe konfigurimin e një sistemi elektronik më nivel të lartë kompleksiteti dhe ndjeshmërie sigurie.

Përvoja profesionale e stafit përbën një tregues të drejtpërdrejtë të cilësisë së realizimit të kontratës, stabilitetit operacional dhe menaxhimit të riskut teknik gjatë fazave të implementimit të sistemit E-Gate.

Stafi teknik i kualifikuar garanton zbatim korrekt të kontratës, integrim të qëndrueshëm të komponentëve hardware dhe software, konfigurim të sigurt të sistemeve dhe menaxhim efektiv të proceseve gjatë gjithë ciklit të implementimit të kontratës.

Në projekte të tilla, roli i **Projekt Menaxherit** është kyç për menaxhimin sa më të mirë në kohë dhe në cilësi të projektit. Ky punonjës, i certifikuar për këtë qëllim, do të ketë kompetencat për të ndjekur projektin, për të bashkërenduar punën, për të ndërvepruar me AK në lidhje me nevojat dhe problematikat e zbatimit të kontratës. Eksperienca e këtij punonjësi është një element kyç që ndikon në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e projektit me cilësi.

Në projekte të tilla, **roli i specialistit të certifikuar në fushën e sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001 Lead Implementer, ISO/IEC 27001 Lead Auditor, CISM, CISSP ose ekuivalent)**- është kyç për menaxhimin sa më të mirë të të dhënave të cilat në këtë projekt janë mjaft sensitive. Kjo për shkak të natyrës së këtij sistemi i cili ka të bëjë drejtpërdrejtë me të dhëna konfidenciale për vetë AK që e zbaton por edhe të tretët. Punonjësi i pajisur me këtë certifikim, është trajnuar për mënyrën sesi këto të dhëna ruhen të sigurt dhe cfarë praktikash ndiqen për këtë qëllim. Eksperienca e këtij punonjësi është një element kyç që ndikon në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e projektit në fushën e sigurisë së të dhënave.

Roli i **specialist për implementimin dhe konfigurimin e integritetit të sistemit përmes API-ve të sigurt, web services ose mekanizmave të ndërveprimit institucional** është kyç për funksionimin e sistemit, i cili për nga natyra ka ndërveprim të disa sistemeve me të dhëna mjaft sensitive të cilat duhet të konfigurohen në mënyrë që sistemi të funksionojë dhe të dhënat të jenë të sigurt. Eksperienca e këtij punonjësi është një element kyç që ndikon në implementimin dhe konfigurimin e të dhënave përmes API-ve të sigurt duke minimizuar risqet dhe për një sukses të ndërveprimit institucional.

Detajimi i pikëzimit është si më poshtë:

2.1 Kualifikimi dhe përvoja e Menaxherit të Projektit të certifikuar (PMP ose ekuivalent). 0 - 15 pikë, e ndarë:

a. Eksperienca në punë si projekt menaxher në vite

0 - 5 pikë

Argumentim: Eksperienca në vite është një element i cili tregon aftësi dhe kompetenca në punë. Përvoja në vite është tregues i drejtpërdrejtë i stabilitetit profesional, aftësisë për të menaxhuar cikle të plota projekti dhe për të përballuar situata komplekse teknike dhe organizative.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale në shkallë zbritëse, projekt menaxheri me më shumë eksperiencë në vite vlerësohet me pikët maksimale (5 pikë) dhe projekt menaxherët e tjerë sipas formulës.

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara. AK mund të kryejë verifikime.

Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b. Eksperienca si projekt menxher në projekte në numër

0 - 5 pikë

Argumentim: Numri i projekteve në të cilat PM ka marrë pjesë është tregues i rritjes së aftësive dhe kompetencave në punë. Numri i projekteve të menaxhuara përbën tregues konkret të përvojës praktike, duke rritur aftësinë për planifikim efektiv, kontroll të afateve dhe menaxhim të riskut.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbritëse, në numër projektesh, ku vlerësohet me pikët maksimale PM i cili ka një numër më të lartë projektesh të cilat ka realizuar (5 pikë) dhe në vazhdim PM-të e tjerë sipas formulës.

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara.

Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

c. Ekpserienca si projekt menaxher në vlerë

0 - 5 pikë

Argumentim: Vlera e projekteve në të cilat PM ka marrë pjesë është tregues i rritjes së aftësive dhe përgjegjesisë në punë. Vlera e projekteve të menaxhuara përbën tregues konkret të përvojës dhe përgjegjësisë duke rritur aftësinë për menaxhim të portofoleve të konsiderueshme dhe projekteve komplekse edhe për shkak të vlerës.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbritëse, në vlerë projektsh, ku vlerësohet me pikët maksimale PM i cili ka një vlerë më të lartë projektsh të cilat ka realizuar (5 pikë) dhe në vazhdim PM-të e tjerë sipas formulës.

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara.

Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

2.2 Kualifikimi dhe përvoja Specialistit me certifikim në fushën e sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001 Lead Implementer, ISO/IEC 27001 Lead Auditor, CISM, CISSP ose ekuivalent.

0 - 10 pikë, e ndarë:

a. Eksperienca në punë në vite

0 - 5 pikë

Argumentim: Eksperienca në vite është një element i cili tregon aftësi dhe kompetenca në punë.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbritëse, specialisti me më shumë eksperiencë në vite vlerësohet me pikët maksimale (5 pikë) dhe specialistët e tjerë sipas formulës.

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara.

Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b. Eksperienca në projekte të ngjashme në numër

0 - 5 pikë

Argumentim: Numri i projekteve në të cilat specialisti ka marrë pjesë është tregues i rritjes së aftësive dhe kompetencave në punë.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbritëse, në numër projektesh, ku vlerësohet me pikët maksimale specialisti i cili ka një numër më të lartë projektesh të cilat ka realizuar (5 pikë) dhe në vazhdim, specialistët e tjerë sipas formulës.

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara.

Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Sqarim: Për shkak të natyrës së ndjeshme dhe kompleksitetit teknik të këtij sistemi, realizimi i kontratës kërkon eksperiencë të provuar në projekte që përmbajnë përbërës teknikë dhe karakteristika funksionale të krahasueshme.

Me “elementë të ngjashëm” nënkuptohen komponentët teknikë që karakterizojnë sistemin E – Gate, konkretisht instalimi dhe integrimi i sistemeve elektronike të kontrollit të aksesit, pajisjeve biometrike, sistemeve të sigurta të komunikimit, si dhe ndërveprimi hardware – software në një arkitekturë të integruar.

Me “tipologji të ngjashme” nënkuptohet natyra e projektit dhe mjedisi i implementimit, pra projekte të realizuara në pika kufitare, porte, aeroporte, institucione shtetërore ose infrastrukturë tjetër kritike, ku kërkohet nivel i lartë sigurie, besueshmërie dhe disponueshmërie e sistemit.

Projektet në elementë dhe tipologji të ngjashme tregojnë që specialisti ka realizuar integrim të sistemeve komplekse elektronike, ka operuar në mjedise me protokolle të posaçme sigurie, si dhe eksperiencë në ndërveprim me sisteme ekzistuese dhe databaza.

2.3 Kualifikimi dhe përvoja e specialistit për implementimin dhe konfigurimin e integritetit të sistemit përmes API-ve të sigurta, web services ose mekanizmave të ndërveprimit institucional.

0 - 10 pikë, e ndarë:

a. Eksperienca në punë në vite

0 - 5 pikë

Argumentim: Eksperienca në vite është një element i cili tregon aftësi dhe kompetenca në punë.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbritëse, specialisti me më shumë eksperiencë në vite vlerësohet me pikët maksimale (5 pikë) dhe specialistët e tjerë sipas formulës.

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara.

Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b. Eksperienca në projekte të ngjashme në vlerë

0 - 5 pikë

Argumentim: Numri i projekteve në të cilat specialisti ka marrë pjesë është tregues i rritjes së aftësive dhe kompetencave në punë.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbritëse, në vlerë projektsh, ku vlerësohet me pikët maksimale specialisti i cili ka një numër më të lartë projektsh të cilat ka realizuar (5 pikë) dhe në vazhdim, specialistët e tjerë sipas formulës.

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara.

Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Baza ligjore për vendosjen e ketyre kriterëve:

LIGJ Nr. 162/2020, PËR PROKURIMIN PUBLIK

Neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. *Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.*

VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar:

Neni 45 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

1. *Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.*

2. *Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.*

Udhërrëfyesit të APP “Mbi përdorimin nga autoritet/entet kontraktore të kriterit të vlerësimit “Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto”, sipas njoftimit nr. 6876 prot., datë 04.10.2024.